



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 681/ 6 prot

Datë 08.04.2024

**V E N D I M**

**Nr. 356 /2024**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.04.2024, shqyrtoi çështjen me:

- Objekt:** Vendim për mbylljen e çështjes për ankesën e operatorit ekonomik “Albanian Distribution Chemicals” SHPK për procedurën e prokurimit “*E hapur e thjeshtuar*” me Nr. REF-98619-03-18-2024, me objekt “*Blerje Hipoklorit Kalciumi dhe Natriumi*” me fond limit: 5,843,667 lekë pa TVSH, për tu zhvilluar më datë 05.04.2024, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Berat SH.A
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Albanian Distribution Chemicals” SHPK me NIPT M11815028I dhe *adresë: Rr. e Kavajës, Buka SH.A, Nr.8240, Njësia Nr.6, Tiranë.*
- Autoriteti Kontraktor:** Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Berat SH.A  
*Adresa: Lagjja nr 1, Rruga Antipatrea, Objekti Nr 7, Berat.*
- Baza Ligjore:** Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”. Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë

5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID-19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

## **Vëren:**

### **I**

#### *Vlerësimi Paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 19.03.2024 në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, është publikuar procedura e prokurimit “E hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-98619-03-18-2024, me objekt “Blerje Hipoklorit Kalciumi dhe Natriumi” me fond limit: 5,843,667 lekë pa TVSH, për tu zhvilluar më datë 05.04.2024, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Berat SH.A

II.2. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike operatori ekonomik “Albanian Distribution Chemicals” SHPK ka paraqitur ankesë me numër ankimi elektronik A/2024/3912 datë 20.03.2024 dhe me nr. 681/2024 prot., datë 21.03.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe pranë Autoritetit Kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4. Me shkresën nr. 259/18 prot., datë 28.03.2024 protokolluar me tonën me nr. 681/3 prot., datë 02.04.2024 është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së ankimuesi bashkëlidhur së cilës gjendet Vendimi me Nr.1, datë 28.03.2024, i KSHA-së mbi shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues ku është vendosur pranimi i plotësisht i ankesës.

### III

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

#### **Arsyeton:**

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Albanian Distribution Chemicals” SHPK, mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit.

III.1.1 Me shkresën nr. 259/18 prot., datë 28.03.2024 protokolluar me tonën me nr. 681/3 prot., datë 02.04.2024 është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së ankimuesi bashkëlidhur së cilës gjendet Vendimi me Nr.1, datë 28.03.2024, i KSHA-së mbi shqyrtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues ku është vendosur pranimi i plotësisht i ankesës.

Referuar pretendimeve të ankimuesit “Referuar dokumeteve të tenderit në shtojcën 6, FORMULARI I SASISË DHE GRAFIKUT TË LËVRIMIT, Çdo parti klori e ardhur në Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Berat Sh.a. do të shoqërohet me fletë analizën të cilat kryen nga laboratorit të Drejtorisë së Shëndetit Publik (I.SH.P.)

#### *1. Grafiku i furnizimit, dhe oraret e dorëzimit të ngarkesave*

*Dërgimet e ngarkesave do të bëhen në bazë të një programi, 2000 l cdo dy muaj 2 e ndare 1500 litra do te depozitohet ne Njesin Dimal dhe 500 litra ne Njesin Skrapar per lenden Hipoklorit Natriumi 12-15% , që Drejtori i Shoqeris Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Berat do t’ja parashtojë firmës kontraktuese me shkresë ose me email të paktën 5 ditë më parë duke përjashtuar rastet e veçanta e të pa parashikueshme kur periudha e mësipërme mund të ulet deri në 3 ditë dhe lajmërimi mund të bëhet edhe me telefon. Kërkesa për kimikate do të bëhet në sasisë dhe datat që do të jetë e nevojshme, kjo do të thotë se ka mundësi që sasisë mujore dhe datat e furnizimit me kimikatet e kërkuara të jetë pak te ndryshme ose të ndryshme krahasuar me grafikun e bashkëlidhur i cili është paraprak dhe orientues.*

Autoriteti Kontraktor ka kerkuar flet analizen nga I.SH.P (Insituti i Shendetit Publik ) per cdo parti mall qe do te furnizohet. Nga ana jone ky kriter eshte lehtesisht i realizueshem por koha qe i duhet ISHP per te realizuar kete analize eshte 20 - 30 dite dhe ky afat bie ndesh me kerkesen qe ben Autoriteti per dorezimin e mallit qe eshte 3 ose 5 dite. Ne vijim te ketij sqarimi ju bejme me dije se Insituti i Shendetit Publik nga momenti qe ben kerksen per kryerjen e analizes deri ne marrjen e kesaj analize zgjat te pakten 20 dite. Per ta vertetuar sa me siper po ju dergojme disa nga Analizat tona te kryera tek ISHP, ne te cilat shihet qarte data e kerkeses dhe data e protokollimit te Analizes (duhet te keni parasysh edhe kohen qe merr dergimi me poste e analizes nga ISHP tek subjekti jone). Bashkangjitur do gjeni disa analiza.

Per kete arsye eshte e pamundur te dorezojme se bashku me Analizen e ISHP per 3 - 5 dite nga momenti i kerkeses tuaj.

**Kerkojme qe te behet nje modifikim tek ky kriter duke marre parasysh sa me siper.**

- Autoriteti kontraktor ka pranuar pretendimet e ankimuesit me Vendimin e KSHA-së si vijon:

[...] Nga verifikimi i dokumenteve të DST , vënë në dispozicion të KSHA-së, si edhe në zbatim të L. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, dhe VKM 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, KSHA analizon se:

KSHA konstaton se specifikimet teknike të cilat lidhen me grafikun e lëvrimin të përcaktuar nga njësia nuk janë të qarta dhe krijojnë pengesa për operatorët ekonomikë pjesmarrës.

**Kriteri ishte:**

Çdo parti klori e ardhur në Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Berat Sh.a. do të shoqërohet me fletë analizën të cilat kyen nga laboratorit të Drejtorisë së Shëndetit Publik (I.SH.P.)

KSHA vlerëson se pretendimi i ankimuesit është i drejte, dhe bazuar në dispozitat ligjore ky kriter duhet të modifikohet si më poshtë:

**Bëhet:**

Çdo ngarkesë klori e ardhur në Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Berat Sh.a. do të shoqërohet me fletë analizën të cilat kyen nga laboratoria e NJVKSH-së

**Shtojca 6**

**Ishte:**

Dorëzimi i ngarkesave se Hipoklorit Kalciumi 60-70% te behet ne magazines se institucionit 2 here, pra 13100 kg brenda 30 ditëve nga nenshkrimi i kontrates dhe 13100 kg pas 7 muajesh nga nenshkrimi i kontrates deri ne perfundimin e plot te sasis ne Adresen Lagja nr.1 Rruga Antipatrea Berat nga e hëna deri të premte, nga ora 8.00 deri në orën 15.00.

KSHA vlerëson se shtojca 6 duhet të saktësohet dhe kriteri duhet të modifikohet si më poshtë:

**Bëhet;**

Dorëzimi i ngarkesave se Hipoklorit Kalciumi 60-70% te behet ne magazines se institucionit 2 here, pra 13100 kg brenda 30 ditëve nga nenshkrimi i kontrates dhe 13100 kg pas me shume se 6-te muajsh nga nenshkrimi i kontrates sipas kerkeses se shoqerise deri ne perfundimin e plot te sasis ne Adresen Lagja nr.1 Rruga Antipatrea Berat nga e hëna deri të premte, nga ora 8.00 deri në orën 15.00.

- Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Albanian Distribution Chemicals” SHPK, mbi modifikimin e kriterit 2.3.2.

“ Me qëllim vërtetimin se produkti objekt prokurimi ihipoklorit Natriumië, është prodhuar nga prodhues të liëncuar, dhe se është në përputhje me specifikimet teknike e standartet e kërkuara, Operatori Ekonomik (Ofertuesi) duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

- Lejen e importit të lëshuar nga Komisioni i Liçensave pranë ministrisë së shendetësisë për llojin e kimikatit, në rast se ofertuesi është vetë importues, dhe në rast se nuk është vetë importues, duhet të paraqesë kontratën e furnizimit me një importues të këtij malli i cili disponon lejen e importit. Autoriteti tek ky kriter ka kerkuar Lejen e importit te Hipoklorit Natriumi me preteksin se ëme qëllim vërtetimin se produkti objekt prokurimi ihipoklorit Natriumië, është prodhuar nga prodhues të liëncuar, dhe se është në përputhje me specifikimet teknike e standartet e kërkuara, Operatori Ekonomik (Ofertuesi) duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë.

Nuk kemi asnje kundërshtim ne lidhje me kete kerkese, por si Hipoklorit Natriumi dhe Hipoklorit Kalciumi do te perdoren per trajtimin e ujit te pijeshem dhe te dy keto produkte kane te njejtin qellim. Madje sasia e Hipoklorit Kalciumi eshte dyfishi me e larte se ajo e Hipoklorit Natriumi dhe kjo kerkese per paraqitjen e Lejes se importit duhet te ishte si per Hipokloritin Natriumit edhe per Hipokloritin e Kalciumit. Nderkohe qe prej shume vitesh, 2017-2023, AK ka kerkuar Lejen e Importit te Hipoklorit Kalciumi vit pas viti dhe i ka refuzuar ankesat tone per ta heq ketij kriteri, madje jemi skualifikuar edhe nje vit per mosparaqitjen e Lejes se importit te Hipoklorit Kalciumit.

Kjo behet per faktin se ky AK me kete kriter dhe kriterin tjetër qe do citojme me poshte favorizon te njejtin Operatori Ekonomik, me arsyen se ketij Operatori i ka skaduar Leja e Importit te Hipoklorit Kalciumit.

**Kerkojme qe ky kriter te modifikohet, ose te vendoset Leja e importit per te dyja mallrat objekt prokurimi ose te hiqet per te dyja.”**

- Autoriteti kontraktor ka pranuar pretendimet e ankimuesit me Vendimin e KSHA-së si vijon: “Çmohet se pretendimi i subjektit është i drejtë dhe se duhet marrë në konsideratë për ndryshime të DST-ve.

KSHA vlerëson se ankesa është e drejtë, dhe bazuar në dispozitat ligjore ky kriter duhet të modifikohet si më poshtë:

**Bëhet:**

2.3.2 Me qëllim vërtetimin se produkti objekt prokurimi “Hipoklorit Natriumi dhe Kalciumi është prodhuar nga prodhues të liçencuar, dhe se është në përputhje me specifikimet teknike e standartet e kërkuara, Operatori Ekonomik (Ofertuesi) duhet të paraqesë dokumentacionin

si më poshtë:

1. Çertifikatën përkatëse që vërteton konformitetin e produktit me standardin (SSH EN 901;2013 dhe SSH EN 900;2014 ).“Kimikate që përdoren për trajtimin e ujërave të destinuara për konsum njerëzor”
2. Leje mjedisore e tipit A të lëshuar nga Ministria e Mjedisit për kimikatin e kërkuar (Në rast se ofertuesi është vetë prodhues )
3. Autorizim të prodhuesit për ofertuesin ose autorizim për ofertuesin nga distributori i autorizuar prej prodhuesit ose që ka lidhur Marrëveshje Bashkëpunimi me prodhuesin (ose ekuivalenti i tij/saj) sipas ligjit. Gjithë këto dokumente duhet të kenë afat vlefshmërie për gjithë kohëzgjatjen e kontratës të kësaj procedure prokurimi, i cili duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, ëbsite, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Ku në rast se autorizimi është lëshuar nga distributori duhet të paraqitet edhe Autorizimi/ Marrëveshja e bashkëpunimit midis distributorit dhe prodhuesit, e cila duhet të jetë e vlefshme në datën e zhvillimit të tenderit.(Në rast se ofertuesi nuk është vetë prodhues)
4. Lejen e importit të lëshuar nga Komisioni i Liçensave pranë Ministrisë së Shendetësisë për llojin e kimikatit, në rast se ofertuesi është vetë importues, dhe në rast se nuk është vetë importues, duhet të paraqesë kontratën e furnizimit me një importues të këtij malli i cili disponon lejen e importit.

**Për sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik “Albanian Distribution Chemicals” SHPK në lidhje me kriterin 2.3.2 qëndrojnë dhe pranohen nga KSHA.**

- Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimes “Albanian Distribution Chemicals” SHPK, mbi modifikimin e kriterit 2.3.3.

*Operatori ekonomik për Hipoklorit Natriumi 12-15%”, duhet të ketë në pronësi ose me qera ose Huapërdorje 1 mjete (autobot) të autorizuar për transport kimikatesh.*

*Për të vërtetuar disponimin e mjeteve të kërkuara më lart operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:*

*a)Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi) për “Transport lende të rrezikshme” ,lejen e qarkullimit, plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme) dhe për mjetet e siguruar me qera, dokumenti që verteton regjistrimin e tij plus certifikatën e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme), duhet të shoqërohet me kontratën përkatëse të qerave/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Në rastin e mjeteve të tjera duhet të jenë aktet e çdoganimit ose faturat tatimore të blerjes.*

*b)Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre.*

*c)Për mjetet e marra me qera ose me huapërdorje të paraqitet kontrata përkatëse e qirasëore të huapërdorjes ku të specifikohet objekti i kontratës dhe afati i saj.*

*d)Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për mjetet e deklaruar ku të jenë të dukshme dhe targat e mjetit.*

e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë në sistemin elektronik se disponon mjete për të realizuar kontratën objekt prokurimi.

*Shënim:* Për pikat (2.3.3) më sipër operatorët ekonomik ofertues duhet të paraqesin formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës nr.8.

Në cdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose ti kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime..

[...] Ky mall mund të transportohet si e përmendëm më sipër dhe me depozita 1000 lit (ose 1200 kg ) sipas grafikut të levrimit. Gjëni të demonstruar me foto mallin e lartpërmendur të transportuar në depozita 1000 lit ( ose 1200 kg). Vendosja e këtyre kritereve çënon hapur ligjin për prokurimin publik përkatësisht: neni 2 dhe neni 3 të ligjit të prokurimit publik Kërkojmë nga ana juaj të merren masa duke hequr ose modifikuar këto kritere pasi çënojnë parimet bazë të LPP duke përjashtuar operatorët e tjerë ekonomik, duke i sherbyer keshtu eliminimit të pengesave të pajustificuara, hapjen e prokurimit publik ndaj konkurrencës si dhe për stimulimin e operatoreve ekonomik.[...]

- Autoriteti kontraktor ka pranuar pretendimet e ankimesit me Vendimin e KSHA-së si vijon: “Çmujmë se pretendimi i subjektit është i drejtë dhe se duhet marrë në konsideratë për ndryshime të DST-ve.

KSHA vlerëson se ankesa është e drejte, dhe bazuar në dispozitat ligjore ky kriter duhet të modifikohet si më poshtë

**Bëhet:**

**2.3.3** Operatori ekonomik duhet të ketë në pronësi ose me qera/Huapërdorje 1 mjet të autorizuar për transport mallrash të rrezikshme sipas standartit të BE.

Për të vërtetuar disponimin e mjeteve të kërkuara më lart operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

Certifikate Pronesie , Leje qarkullimi, certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme)Dhe për mjetet e mara me qera, kontraten perkatese të Qerave/Huapërdorje të shoqeruar me Certifikate Pronesie leje qarkullimi, certifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit,(te vlefshme), për të gjithë periudhen e realizimit të kontrates objekt i ketij prokurimi.

**Shënim:** Ky kriter (2.3.3) do të konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas Shtojcës 8 të DST. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqiten në rastin kur OE renditet I pari në vlerësim para publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

**Argumentimi:** Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe neni 40, pika 5/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, Ligjit nr.8308, datë 18.3.1998 “Për transportet rrugore” (të ndryshuar), Udhëzimi Nr.15, datë 24.7.2007 ”Për kriteret dhe procedurat e lëshimit të licencave, autorizimeve dhe certifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor me anë të ketij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën,

të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate janë furnizimi në mënyrë periodike i një sasive të konsiderueshme mallrash specifike dhe me funksione speciale, automjeti i mësipërm konsiderohet i domosdoshëm pasi duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj dhe vendodhjen e objektit në të cilin do të kryhen furnizimet, i shërben Autoritetit Kontraktor për t'u bindur me kapacitetet teknike të ofertuesve me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës. Furnizimi me kimikate do të kryhet me automjet të çertifikuara për transportin e lëndëve të rrezikshme sipas standartit të BE. Automjeti për transportin e kimikateve duhet të jenë të përshtatëshme për të mbajtur prodhim të destinuar për trajtimin e ujit të pijshëm. Ato nuk duhet të kenë transportuar më parë substanca të dëmshme ose të konsideruara si të tilla për ndotjen e ngarkesës së kimikatit.

**Për sa më sipër pretendimet e operatorit ekonomik “Albanian Distribution Chemicals” SHPK në lidhje me kriterin 2.3.3 qëndrojnë dhe pranohen nga KSHA.**

*Në lidhje me ankesën e operatorit ekonomik “Albanian Distribution Chemicals” SHPK  
Grupi i punës sa më sipër,*

**Vendosi:**

*Pranimin plotësisht të ankesës së paraqitur nga “Albanian Distribution Chemicals” SHPK me me NIPT M11815028I dhe adresë: Rr. e Kavajës, Buka SH.A, Nr.8240, Njësia Nr.6, Tiranë.*

III.1.2. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera”.

III.1.3. Neni 115 pikat 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se:

1. “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga



operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.1.4. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton se, nuk ka pretendime apo argumenta nga ankimuesi pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në përputhje me nenin 113 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 30, 115 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik njëzëri,

### **Vendosi**

1. Të mbyllë çështjen mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Albanian Distribution Chemicals” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-98619-03-18-2024, me objekt “Blerje Hipoklorit Kalciumi dhe Natriumi” me fond limit: 5,843,667 lekë pa TVSH, për tu zhvilluar më datë 05.04.2024, nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Berat SH.A
2. Autoriteti kontraktor të bëjë modifikimet dhe sqarimet me shtojcën përkatëse të dokumenteve të tenderit në SPE.

3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Albanian Distribution Chemicals” SHPK.
5. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

